



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 218

Tiranë – E martë, 15 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

Faqe

Ligj nr. 135/2020, datë 16.11.2020	Për disa ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar.....	16793
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 993, datë 9.12.2020	Për miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, të ujërave ndërkufitare, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre.....	16793
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 994, datë 9.12.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit, për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.....	16797
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 995, datë 9.12.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 280, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Tërbuf të qarkut të Fierit”.....	16797
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 999, datë 9.12.2020	Për miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – tema: Njësitë statistikore”.....	16799
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1000, datë 9.12.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 47, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.....	16838
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1002, datë 9.12.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 433, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Studim projektim <i>by-pass</i> Tepelenë, loti 1”.....	16838

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1003, datë 9.12.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 406, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen në përdorim të përkohshëm dhe vendosjen e servitutit për interes publik mbi pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i korridorit të kalimit të gazsjellësit TAP (pjesë e projektit TAP)”.....	16841
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1004, datë 9.12.2020	Për përcaktimin e masës së tarifës, sipas llojeve të përdorimit të faunës së egër dhe mënyrat e pagimit të saj.....	16855
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1005, datë 9.12.2020	Për miratimin e rregullores “Për procesin e çmontimit të sigurt të objekteve, të cilat kryejnë veprimtari me lëndë radioaktive, me qëllim mbrojtjen e publikut, të punonjësve dhe të mjedisit”.....	16856
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1006, datë 2.12.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 945, datë 2.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore’”.....	16862
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1009, datë 9.12.2020	Për miratimin e projekt marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Federatës Shqiptare të Futbollit, për bashkëpunim në fushën e ndërtimit të banesave.....	16863
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1010, datë 9.12.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Vorë dhe Kavajë.....	16866
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 73, datë 2.12.2020	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarive financiare shtesë nga Banka Amerikane e Investimeve sh.a.....	16866
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 74, datë 2.12.2020	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarive financiare shtesë nga Banka Credins sh.a.....	16867

VENDIM
Nr. 1005, datë 9.12.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCESIN E ÇMONTIMIT TË
SIGURT TË OBJEKTEVE, TË CILAT KRYEJNË VEPRIMTARI ME LËNDË
RADIOAKTIVE, ME QËLLIM MBROJTJEN E PUBLIKUT, TË PUNONJËSVE
DHE TË MJEDISIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për procesin e çmontimit të sigurt të objekteve, të cilat kryejnë veprimtari me lëndë radioaktive, me qëllim mbrojtjen e publikut, të punonjësve dhe të mjedisit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet dhe Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet pas 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULLORE
**PËR PROCESIN E ÇMONTIMIT TË SIGURT TË OBJEKTEVE, TË CILAT KRYEJNË
VEPRIMTARI ME LËNDË RADIOAKTIVE, ME QËLLIM MBROJTJEN E PUBLIKUT,
TË PUNONJËSVE DHE TË MJEDISIT**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kërkesat e përgjithshme të sigurisë që duhet të përmbushen gjatë realizimit të procesit të çmontimit të objekteve që kryejnë veprimtari me lëndë radioaktive, kryerjen e veprimeve të çmontimit dhe menaxhimin e mbetjeve radioaktive që rezultojnë nga ky proces, ushtrimin e së drejtës për realizimin e këtij procesi, si dhe përfundimin e veprimeve të procesit të çmontimit.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për çmontimin e objekteve, të cilat përdoren për menaxhimin e përkohshëm të mbetjeve radioaktive, objektet, të cilat merren me procesimin e lëndëve radioaktive me origjinë natyrore (NORM), objektet mjekësore, industriale dhe kërkimore-shkencore.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet për objektet e depozitimit përfundimtar të mbetjeve radioaktive, objekteve të depozitimit përfundimtar të materialeve radioaktive me origjinë natyrore (NORM) dhe për mbetjet nga minierat dhe përpunimi i mineraleve.

3. Kjo rregullore nuk adreson rehabilitimin e zonave të ndotura nga materiali radioaktiv i mbetur që rrjedh nga aktivitetet e kaluara që nuk kanë qenë asnjëherë objekt i licencimit të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet.

4. Kjo rregullore nuk adreson përmirësimin e zonave të prekura nga një emergjencë bërthamore ose radiologjike, pasi emergjenca është deklaruar e përfunduar.

5. Aspektet e sigurimit fizik të lëndës radioaktive janë jashtë fushës së veprimit të kësaj rregulloreje dhe do të trajtohen në përputhje me vendimin nr. 877, datë 30.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë’”.

Neni 3

Përcaktime

1. I licencuari është personi fizik/tregtar ose juridik që ka marrë licencën për veprimtaritë e përcaktuara në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar. I licencuari ka përgjegjësinë kryesore për veprimtarinë me burime të rrezatimit jonizues, për të cilën është licencuar.

2. Çmontimi nënkupton veprimet administrative dhe teknike të ndërmarra nga i licencuari për të lejuar heqjen e disa ose të të gjitha kontrolleve rregullatore mbi një objekt që përmban lëndë radioaktive.

3. Veprimet e çmontimit nënkuptojnë procedurat, proceset, menaxhimin e mbetjeve radioaktive, të cilat kryhen siç përshkruhen në planin e miratuar të çmontimit, pjesë përbërëse e shtojcës I, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, të cilat konsiderohen të përfunduara kur janë kryer në përputhje me këtë plan.

4. Plan çmontimi nënkupton një dokument, i cili jep informacione të detajuara të propozuara për çmontimin e objektit, si dhe përshkruan veprimet që do të ndërmerren për kryerjen e procedurave, proceseve dhe aktiviteteve të punës për këtë qëllim, siç përcaktohet në shtojcën I bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 4

Vlerësimi i kërkesave të sigurisë për çmontimin

1. Vlerësimi për sigurinë përgatitet nga i licencuari në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga rrezatimi.

2. Kërkesat për vlerësimin e sigurisë, të cilat janë pjesë e planit të çmontimit, përfshijnë të gjitha objektet që planifikohen të çmontohen, incidentet, aksidentet që mund të ndodhin gjatë çmontimit.

Neni 5

Përgjegjësitë e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet për çmontimin

1. Përgjegjësitë e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet janë:

a) krijimi i një kuadri ligjor dhe rregullator për të gjitha aspektet e çmontimit, përfshirë menaxhimin e mbetjeve radioaktive që rezultojnë nga ky proces, për të garantuar sigurinë e këtij procesi;

b) njohja e së drejtës për realizimin e procesit të çmontimit, nëpërmjet licencimit për kryerjen e këtij procesi;

c) përcaktimi i kërkesave për kryerjen eurvejimit radiologjik për përcaktimin e niveleve të ndotjes në objekt;

ç) përcaktimi i kërkesave që lidhen me kriteret për sigurinë, mbrojtjen e punonjësve, të publikut dhe mbrojtjen e mjedisit gjatë procesit të çmontimit të objekteve, duke përfshirë kriteret

për çlirimin e materialit radioaktiv nga kontrolli i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) përcaktimi i kërkesave për planifikimin e çmontimit, duke përfshirë:

i. specifikimin e përmbajtjes të planit të çmontimit, sipas shtojcës I bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

ii. hartimin e procesit të rishikimit për planet e çmontimit, dokumentet mbështetëse dhe afatin kohor për rishikime të tilla;

iii. rishikimin e planit të çmontimit, si dhe rishikimin e miratimit e përditësimeve pas çdo ndryshimi të elementeve të planit të çmontimit.

dh) miratimin e programit të mbikëqyrjes dhe të monitorimit të sigurisë gjatë gjithë periudhës, në rastin e çmontimit me faza;

e) miratimin e raportit përfundimtar të realizimit të procesit të çmontimit.

Neni 6

Përgjegjësitë e të licencuarit për procesin e çmontimit

1. I licencuari planifikon procesin e çmontimit dhe kryen veprimet e çmontimit në përputhje me licencën për ushtrim aktiviteti me lëndët radioaktive dhe çmontim, si dhe me kërkesat që parashikon kjo rregullore.

2. I licencuari është përgjegjës për të gjitha aspektet e sigurisë dhe të mbrojtjes nga rrezatimi gjatë çmontimit.

3. Përgjegjësitë e të licencuarit janë:

a) përgatitja dhe paraqitja e planit të çmontimit dhe e përditësimeve që i janë bërë, për rishikim e miratim nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, i cili përmban elementet, siç përcaktohen në shtojcën I bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

b) përzgjedhja e një strategjie për çmontimin si bazë për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e planit të çmontimit gjatë gjithë jetës së objektit;

c) krijimi dhe implementimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të procesit të çmontimit;

ç) vlerësimi i kostos financiare të veprimeve të çmontimit, sigurimi i garancive financiare dhe i burimeve për të mbuluar kostot që lidhen me çmontimin e sigurt, përfshirë menaxhimin e mbetjeve radioaktive që rezultojnë nga ky proces, si dhe për monitorimin e objektit në rast kufizimi në përdorimin e ardhshëm të tij;

d) njoftimin e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet para mbylljes së përhershme të objektit;

dh) menaxhimi i mbetjeve nga aktivitetet operationale nga objekti dhe të gjitha mbetjet radioaktive nga procesi i çmontimit në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) sigurimi fizik i objektit gjatë periudhës së tranzicionit deri në mbylljen e përhershme të tij;

ë) kryerja e vlerësimeve të sigurisë dhe vlerësimet për ndikimin në mjedis në mbështetje të veprimeve për çmontim;

f) përgatitja dhe zbatimi i procedurave të përshtatshme të sigurisë, përfshirë planet e reagimit në rast të emergjencës;

g) sigurimi i zbatimit të planit të çmontimit nëpërmjet stafit të trajnuar, të kualifikuar dhe kompetent;

gj) kryerja eurvejimeve radiologjike në mbështetje të planit të çmontimit;

h) verifikimi që kriteret e fazës finale janë përmbushur duke kryer njëurvejim përfundimtar për rrezatimin;

i) mbajtja dhe ruajtja e shënimeve, regjistrave dhe raporteve të përshtatshme, të cilat ruhen gjatë gjithë kohës që ky objekt do të jetë funksional e që mund të shërbejnë gjatë procesit të çmontimit.

Neni 7

Sistemi i integruar i menaxhimit të procesit të çmontimit

1. I licencuari mbulon të gjitha aspektet e çmontimit sipas një sistemi të integruar të menaxhimit që konsiston në planifikimin dhe zbatimin e veprimeve të çmontimit.
2. Sistemi i integruar i menaxhimit siguron:
 - a) përshkrimin e proceseve të nevojshme për realizimin e procesit të çmontimit. Këto procese përfshijnë elementet që lidhen me mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë, sigurimin, si dhe elemente ekonomike, të cilat janë objekt rishikimi nga personi përgjegjës për sigurinë;
 - b) përcaktimin e personave përgjegjës për veprimet që do të ndërmerren gjatë procesit të çmontimit, të cilët duhet të kenë aftësitë, ekspertizën dhe trajnimin e nevojshëm, me qëllim kryerjen e procesit të çmontimit në mënyrë të sigurt.
3. Personat përgjegjës, gjatë kryerjes së veprimeve, detyrohen të informojnë të licencuarin për çdo çështje që mund të cenojë sigurinë e procesit të çmontimit.

Neni 8

Strategjia për procesin e çmontimit

1. I licencuari zgjedh një strategji për çmontimin, të menjëhershme ose me faza, e cila është një nga elementet e planit të çmontimit. Strategjia duhet të jetë në përputhje me politikën kombëtare për menaxhimin e mbetjeve radioaktive dhe me kërkesat rregullatore.
2. Strategjia e preferuar për çmontimin është çmontimi i menjëhershëm. Në rast se zgjidhet strategjia e çmontimit me faza të ndryshme, i licencuari demonstroi në planin e çmontimit edhe dokumentet mbështetëse se ky opsion i zgjedhur do të zbatohet në mënyrë të sigurt.
3. Përzgjedhja e strategjisë së çmontimit justifikohet nga i licencuari.
4. I licencuari demonstroi që, nën strategjinë e zgjedhur, objekti mbahet i sigurt në çdo kohë dhe do të arrijë në gjendjen përfundimtare të caktuar të çmontimit, pa lënë pas kontaminime të mundshme për brezat e ardhshëm, duke paraqitur programin për monitorim dhe mbikëqyrje lidhur me sigurinë e objektit gjatë gjithë periudhës.
5. Nëse mbyllja e një objekti ndodh në mënyrë të papritur, strategjia e çmontimit rishikohet në bazë të situatës që shkaktoi mbylljen e papritur të objektit, për të përcaktuar nëse kërkohet rishikimi i strategjisë.
6. Nëse mbyllja është shkaktuar nga një aksident, objekti duhet të jetë i sigurt deri në zbatimin e planit të aprovuar të çmontimit.

Neni 9

Financimi i procesit të çmontimit

1. Kostot financiare për procesin e çmontimit mbulohen nga i licencuari me qëllim garantimin që burimet e duhura financiare për të mbuluar kostot e lidhura me çmontimin e sigurt, përfshirë edhe menaxhimin e mbetjeve që rezultojnë nga ky proces, të jenë në dispozicion kur është e nevojshme.
2. Vlerësimi i kostos për procesin e çmontimit mund të përditësohet nga i licencuari deri në realizimin përfundimtar të planit të çmontimit në bazë të përditësimit periodik të planit fillestar të çmontimit ose në bazë të planit përfundimtar të çmontimit.
3. Nëse, pas çmontimit, objekti i vendosen kufizime në përdorimin e tij të ardhshëm, i licencuari mbulon kostot financiare që janë në dispozicion për monitorimin dhe mbikëqyrjen e objektit gjatë gjithë periudhës së nevojshme kohore.

Neni 10

Përgatitja dhe rishikimi i planit të çmontimit

1. I licencuari përgatit një plan për çmontimin dhe e ruan atë gjatë gjithë kohës që ky objekt do të jetë funksional, në përputhje me elementet e të cilit janë bashkëlidhur në shtojcën I. Ky plan i çmontimit është i detyrueshëm për t'u paraqitur në mënyrë që të identifikohen mënyrat e çmontimit, të demonstron mundësia e çmontimit, për të siguruar gëzimin e kapaciteteve të mjaftueshme financiare në dispozicion për procesin e çmontimit dhe menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive që do të prodhohen gjatë këtij procesi.

2. Në përgatitjen e planit të çmontimit merren parasysh faktorë, si: projektimi, modifikimet dhe historia e funksionimit të objektit, strategjia që ndiqet për procesin e çmontimit, veprimet e çmontimit, menaxhimi i mbetjeve radioaktive, kostot e çmontimit, vlerësimi për sigurinë, analizat dhe parashikimet e bëra në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe të dokumenteve të tjera të hartuara gjatë procesit të VNM-së, në rast se objekti është pajisur me VNM-në paraprake ose deklaratën mjedisore.

3. Për objektet ekzistuese, kur nuk ka një plan të çmontimit, i licencuari apo subjekti që kërkon të licencohet përgatit një plan çmontimi, në përputhje me kërkesat, siç përcaktohen në shtojcën I bashkëlidhur kësaj rregulloreje, dhe e paraqet në Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet, brenda 6 muajsh pas hyrjes në fuqi të rregullores, së bashku me kërkesën për pajisje me licencë apo amendim licence për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues, në përputhje me vendimin nr. 10, datë 7.1.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese'".

4. I licencuari mund të përditësojë planin e çmontimit në çdo element të tij, duke garantuar që metodat që do të përdoren janë të sigurtat e që arrijnë në mënyrë efektive rezultatin e dëshiruar, si dhe duke paraqitur informacionet shtesë për fazat vijuese të procesit në rastin e projekteve të mëdha dhe komplekse të çmontimit.

5. Plani i çmontimit përditësohet nga i licencuari, i cili rishikohet dhe miratohet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet në mënyrë periodike, për çdo ndryshim në elementet e tij duke u amenduar licenca përkatëse, sipas kërkesës që duhet të paraqitet nga i licencuari për këtë qëllim.

6. I licencuari njofton Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet kur të mbyllë objektin në mënyrë të përhershme.

Neni 11

Kryerja e veprimeve të çmontimit

1. I licencuari zbaton planin e çmontimit, duke përfshirë dhe menaxhimin e mbetjeve radioaktive, në përputhje me rregulloret në fuqi.

2. I licencuari zbaton planin e çmontimit pasi Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet ta ketë aprovuar atë.

3. Në përputhje me planin e çmontimit, teknikat e çmontimit zgjidhen dhe kryhen në mënyrë të tillë që mbrojtja dhe siguria të jenë optimizuar, prodhimi i mbetjeve radioaktive dhe çdo ndikim i mundshëm negativ në vendin e ruajtjes së mbetjeve radioaktive të minimizohet.

4. Në rastet e shfaqjes së rreziqeve të reja (të paparashikuara) gjatë kryerjes së veprimeve të çmontimit, të cilat do të ndikojnë mbi sigurinë, atëherë veprimet e çmontimit që do të ndërmerren, duhet të vlerësohen e menaxhohen në mënyrë që pasojat e mundshme të tyre të parandalohen ose të zbulohen në kohë dhe ndikimi i tyre të ulet.

5. Në rast emergjence gjatë procesit të çmontimit, veprimet reaguese të çmontimit kryhen në përpjesëtim me rreziqet dhe duhet të raportohen në kohën e duhur në Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet.

6. Veprimet e çmontimit janë objekt inspektimi dhe rishikimi nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, me qëllim sigurimin se ato kryhen në përputhje me planin e çmontimit dhe licencën për të kryer procesin e çmontimit dhe kushtet e licencës.

7. Nëse nuk përmbushen kërkesat e sigurisë dhe kushtet e licencimit për të kryer procesin e çmontimit, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ndërmerr veprimet e duhura bazuar në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe në vendimin nr. 10, datë 7.1.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizues”.

Neni 12

Menaxhimi i mbetjeve radioaktive

1. I licencuari mbulon të gjitha aspektet e menaxhimit të mbetjeve radioaktive që rrjedhin nga aktivitetet operacionale që mbeten në strukturë dhe mbetjet radioaktive që gjenerohen gjatë procesit të çmontimit, në përputhje me vendimin nr. 638, datë 7.9.2016, “Për miratimin e rregullores ‘Për trajtimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë’”.

2. Gjatë procesit të çmontimit, i licencuari:

a) siguron gjurmueshmërinë për të gjitha mbetjet radioaktive të krijuara gjatë procesit të çmontimit;

b) mban të përditësuar të dhënat lidhur me mbetjet radioaktive, të ruajtura në objekt apo të transferuara në një objekt tjetër të autorizuar, duke specifikuar sasinë, karakteristikat, metodat e trajtimit dhe destinacionin e tij final;

c) kryen, sipas rastit, transferimin e tyre në një institucion të autorizuar, në përputhje me vendimin nr. 815, datë 16.11.2016, “Për miratimin e rregullores ‘Për transportin e sigurt të materialeve radioaktive’”.

Neni 13

Përfundimi i veprimeve për procesin e çmontimit

1. I licencuari vërteton përfundimin e veprimeve të çmontimit sipas planit të çmontimit dhe përgatit raportin përfundimtar, ku përshkruhet realizimi i këtij procesi me elementet e përcaktuara në shtojcën II bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

2. Raporti përfundimtar i realizimit të procesit të çmontimit paraqitet për vlerësim në Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet, e cila verifikon pajtueshmërinë me planin e çmontimit dhe e dërgon për procedurë të mëtejshme në Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet, duke miratuar raportin përfundimtar për këtë proces.

3. Nëse Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, pas verifikimit të raportit përfundimtar, konstaton dhe vendos kufizime në përdorimin e ardhshëm të strukturave të mbetura, si: objekt/pajisje e paçmontuar ose e çmontuar pjesërisht, i licencuari garanton programe të përshtatshme për monitorim dhe mbikëqyrje të vazhdueshme, me qëllim ruajtjen e sigurisë nga rrezatimi jonizues, të cilat i paraqet paraprakisht në Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet.

4. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet miraton programet, siç përcaktohen në pikën 3, të cilat do të jenë objekt kontrolli i vazhdueshëm nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet.

5. Gjatë përgatitjes të raportit të çmontimit, përcaktohet, nëpërmjet procesit të karakterizimit, sasia dhe lloji i materialit radioaktiv në objekt, strukturat, përbërësit e aktivuar e të kontaminuar. Nëse nga veprimet e kryera, kontaminimi ose mbetjet radioaktive mbeten në objekt, në tokë, në sipërfaqe dhe ujëra nëntokësore, procesi i karakterizimit merr në konsideratë veçoritë shtesë që lidhen me vendndodhjen e objektit, me qëllim vlerësimin dhe parandalimin e shpërhapjes së mundshme të materialeve radioaktive.

6. Nëse mbetjet radioaktive ruhen në objekt pasi të ketë përfunduar procesi i çmontimit, ruajtja e mbetjeve bëhet në përputhje me vendimin nr. 638, datë 7.9.2016, “Për miratimin e rregullores ‘Për trajtimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë’”.

7. Pas miratimit të raportit përfundimtar, i licencuari krijon një sistem arkivimi, duke siguruar që të gjitha të dhënat ruhen në përputhje me kërkesat për ruajtjen e të dhënave, me qëllim që përdoruesit e rinj të objektit, pas lëshimit të tij nga kontrolli rregullator, të informohen për natyrën e aktiviteteve që janë kryer në të kaluarën në këtë objekt.

SHTOJCË I ELEMENTET E PLANIT TË ÇMONTIMIT

Plani i çmontimit duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

1. Përshkrimi i objektit;
2. Historia e funksionimit të objektit;
3. Strategjia e çmontimit;
4. Veprimet e çmontimit;
5. Menaxhimi i mbetjeve radioaktive;
6. Transporti/transferimi i mbetjeve radioaktive;
7. Kostoja e çmontimit dhe vlerësimi i tyre;
8. Vlerësimi i sigurisë;
9. Vlerësimi i mjedisit;
10. Sistemi i integruar i menaxhimit të procesit të çmontimit;
11. Plani i reagimit, në rast emergjence gjatë procesit të çmontimit;
12. Sigurimi fizik;
13. Survejimi radiologjik në lidhje me rrezatimin.

SHTOJCË II FORMATI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË PROCESIT TË REALIZIMIT TË ÇMONTIMIT

Formati i raportit të procesit të çmontimit duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

1. Përshkrimi i objektit;
2. Objektivat e çmontimit;
3. Kriteret radiologjike dhe joradiologjike që përdoren si bazë për çlirimin e objekteve ose vendndodhjes së objekteve nga kontrolli rregullator;
4. Një llogaritje e dozës përfundimtare për çdo banor të mundshëm të vendndodhjes së objektit pas çlirimit nga kontrolli rregullator;
5. Një përshkrim i veprimeve të çmontimit;
6. Një përshkrim i ndonjë objekti ose pajisjeje të paçmontuar ose të çmontuar pjesërisht;
7. Raporti përfundimtar iurvejimit radiologjik;
8. Një inventar i mbetjeve radioaktive, duke përfshirë sasi të dhe llojet e tyre të prodhuara gjatë procesit të çmontimit dhe vendndodhjeve për ruajtjen e tyre;
9. Një inventar i mbetjeve joradioaktive, duke përfshirë sasi të dhe llojet e mbetjeve joradioaktive të gjeneruara gjatë procesit të çmontimit, si dhe vendndodhjeve për ruajtjen e tyre;
10. Një inventar i materialeve, pajisjeve dhe ambienteve të çliruara nga kontrolli rregullator;
11. Një listë e strukturave, zonave ose pajisjeve të përcaktuara për përdorim të kufizuar në të ardhmen;
12. Një krahasim i vëllimeve aktuale të mbetjeve radioaktive të gjeneruara gjatë aktiviteteve të çmontimit me sasi të parashikuara në fazën e planifikimit;
13. Një përmbledhje e çdo ngjarjeje dhe incidenteve jonormale që kanë ndodhur gjatë procesit të çmontimit;
14. Një përmbledhje të dozave të rrezatimit të marra nga punonjësit dhe anëtarët e publikut gjatë procesit të çmontimit.